PSH.nr.974/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Blerim Dina - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "TEKNIKA"SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Matkos Pharm" shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material mbrojtës për COVID 19 – K.K. Dragash", me numër të prokurimit: 621-20-5736-1-2-1iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Dragash, më datën: 01.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "TEKNIKA"SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material mbrojtës për COVID 19 – K.K. Dragash", me numër të prokurimit: 621-20-5736-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK Dragash.

II. <u>VËRTETOHET</u>, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material mbrojtës për COVID 19 – K.K. Dragash", me numër të prokurimit: 621-20-5736-1-2-1iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Dragash.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "TEKNIKA"SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "TEKNIKA"SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 19.11.2020 me nr. 974/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material mbrojtës për COVID 19 – K.K. Dragash", me numër të prokurimit: 621-20-5736-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Dragash, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.974/20 ka të bëjë me arsen e eliminimit nga ana e AK-KK Dragash.

OE ankues pretendon se eliminimi tij nga AK me arsyetim se i njëjti nuk ka licencë për qarkullim me shumicë është I padrejtë sepse në dosje të tenderit (gjithnjë sipas OE ankues) është lënë mundësia që licence të jetë për pakicë ose për shumicë.

Pas analzimit të pretendimeve ankimore dhe dosjes së tenderit, konstatojmë se kërkesa decidive e AK-së është si në vijim:

2. Qarkullues pakice me shumice per barna dhe pajisje medicinale,	**2. Licenca e lëshuar nga AKPPM për qarkullimin me pakice dhe shumice për barna medicinale- (Valide)-Kopje**

Vlerësimi ynë është se kërkesa e AK-së për OE-të është se të njëjtit duhet të kenë licencë si për qarkullim me pakicë e po ashtu edhe për qarkullim me shumicë, do thotë duhet të kenë licencë për të dyja.

Pas analizimit të ofertës të OE ankues kemi gjetur se licenca ofruar në emër të anëtarit "An Pharm" është "Licencë veprimtarie –Barnatore Komunitare-Qarkullues me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale". Nga kjo vlerësojmë se licenca e ofruar nga OE ankues nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së për "Licenca e lëshuar nga AKPPM per qarkullimin me pakice **dhe shumice** për barna medicinale- (Valide)-Kopje". Po ashtu, duhet theksuar se sipas njoftimit për tenderuesin e eliminuar (të shënuar më lart), arsyeja e dytë për eliminim të OE është mungesa e ISO certifikatave për produktet e ofruara.

Kërkesa dosjes :

3.Per cdo produkt duhet te 3.Certifikat ISO dhe CE -(Valide)-

kete ISO dhe CE certificate Kopje)

Pas analizimit të ofertës të OE ankues nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar ISO certifikata për të gjitha produktet e ofertuara. Me gjithë se (siq pretendon edhe OE ankues) AK në pajtim me dispozitat ligjore të LPP ka mund të kërkoj informatë sqaruese sa i përket ISO certifikatave, andaj konsiderojmë se ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Kërkoj nga paneli ta aprovoj ankesën tone.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 01.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin

e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "TEKNIKA"SH.P.K-Prishtinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk ka licencë për qarkullim me shumicë dhe se ky vendim është i padrejtë sepse në dosje të tenderit (gjithnjë sipas OE ankues) është lënë mundësia që licenca të jetë për pakicë ose për shumicë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe dosjes së tenderit, konstaton se kërkesa decidive e AK-së është si në vijim:

2. Qarkullues pakice me shumice per barna dhe pajisje medicinale,	**2. Licenca e lëshuar nga AKPPM për qarkullimin me pakice dhe shumice për barna medicinale- (Valide)-Kopje**

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se kërkesa e AK-së për operatorët ekonomik është se të njëjtit duhet të kenë licencë si për qarkullim me pakicë e po ashtu edhe për qarkullim me shumicë, do thotë duhet të kenë licencë për të dyja. Kurse, pas analizimit të ofertës të OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se licenca ofruar në emër të anëtarit "An Pharm" është "Licencë veprimtarie –Barnatore Komunitare-Qarkullues me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale". Nga kjo vlerësojmë se licenca e ofruar nga OE ankues nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së për "Licenca e lëshuar nga AKPPM per qarkullimin me pakice dhe shumice për barna medicinale - (Valide)-Kopje". Po ashtu, duhet theksuar se sipas njoftimit për tenderuesin e eliminuar (të shënuar më lart), arsyeja e dytë për eliminim të OE është mungesa e ISO certifikatave për produktet e ofruara. Kurse, kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë:

- 3.Per cdo produkt duhet te 3.Certifikat ISO dhe CE -(Valide)- kete ISO dhe CE certificate Kopje)

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës të OE ankues nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar ISO certifikata për të gjitha produktet e ofertuara. Megjithatë, (siç pretendon edhe OE ankues) AK në pajtim me dispozitat ligjore të LPP ka mund të kërkoj informatë sqaruese sa i përket ISO certifikatave, andaj ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe shkresave të lëndës, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se operatori ekonomik ankues nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në dosje të tenderit lidhur me licencën si për qarkullim me pakicë e po ashtu edhe për qarkullim me shumicë. Andaj, në mungesë të kësaj licence ky OE nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit. Pra, Paneli Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues ka bërë ekzamnimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK Dragash";

1x1 OE "TEKNIKA"shpk-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.